

nr. 648/Prot
08.07.2020



Nr. 8 prot.

Tiranë, më 08 / 07 /2020

VENDIM

Nr. 8, datë 08 / 07 /2020

**“MBI
KARAKTERISTIKAT E FLETËVE TË VOTIMIT, PËR ZGJEDHJET E
AUTORITETEVE DREJTUESE DHE SENATIN AKADEMIK, NË UNIVERSITETIN E
ARTEVE”**

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; Vendimit të Senatit Akademik nr. 19, datë 10.02.2020 Mbi miratimin e Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe senatin akademik në Universitetin e Arteve”; si dhe të Urdhrave të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 8, dt. 14.01.2020 “Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë” (i ndryshuar), me nr. 108, datë 08.05.2020 “Për shtyrjen e datës së zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë, për shkak të gjendjes së fatkeqësisë natyrore shkaktuar nga pandemia e COVID-19” dhe me nr. 175, datë 30.06.2020 “Zhvillimin e procesit zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në IAL-të Publike në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni Institucional i Zgjedhjeve të Universitetit të Arteve, në mbledhjen e datës 09.07.2020, pasi diskutoi me votim të hapur,

VENDOSI:

1. Në zbatim të nenit 29 të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për Autoritetet Drejtuese dhe Senatin Akademik në Universitetin e Arteve” karakteristikat e fletëve të votimit për personelin akademik janë si më poshtë:
 - Fletë votimi për Rektor, ngjyra jeshile, format A4, shkrimi Times New Roman 16;
 - Fletë votimi për Drejtues të Njesisë Kryesore, ngjyra portokalli, format A4, shkrimi Times New Roman 16;
 - Fletë votimi për Drejtues të Njesisë Bazë, ngjyra rozë, format A4, shkrimi Times New Roman 16;



REPUBLIKA E SHQIPERISE
UNIVERSITETI I ARTEVE
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

- Fletë votimi për anëtar të Senatit Akademik nga personeli akademik, ngjyra e bardhë, format A4, shkrimi Times New Roman 16.
2. Karakteristikat e fletëve të votimit për studentët janë si më poshtë:
- Fletë votimi për Rektor, ngjyra e kuqe, format A4, shkrimi Times New Roman 16;
 - Fletë votimi për Drejtues të Njesisë Kryesore, ngjyra blu, format A4, shkrimi Times New Roman 16;
 - Fletë votimi për anëtar të Senatit Akademik, përfaqësues i studentëve ngjyra e verdhë, format A4, shkrimi Times New Roman 16.
3. Ky vendim të dërgohet pranë Komisioneve Zgjedhore nëpër Fakultete dhe Administratores të UART për mundësimin e bazës materiale për krijimin e fletëve të votimit.
4. Ky vendim të publikohet në faqen elektronike të Universitetit të Arteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Ergys Krisiko

Anëtar

Orges Malaj

Anëtar

Ted Kamberi

Anëtar

Albjon Begaj

Anëtar

Suela Agolli

Kryetar

Sekretar: Armira Kapxhiu

